



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 413/1 Prot.

Tiranë, më 24.02.2026

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____._____.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 260, datë 10.11.2025¹, e paraqitur nga z. A. M., kundër Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” dhe ZVAP Tiranë, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijëve të tij të mitur, A., S. dhe O. M., për shkak të “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe në dokumentacionin plotësues të dërguar me email-in datë 05.12.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë, A. M., në cilësinë e prindit/përfaqësuesit ligjor të nxënësit A., S. dhe O. M., paraqes këtë ankesë pranë institucionit tuaj për shkak të një praktike që e konsideroj diskriminuese dhe poshtëruese ndaj fëmijëve të kthyer nga emigracioni.

Sipas Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë” dhe praktikës së zbatuar nga ZVAP/DRAP, nxënësit që kthehen nga emigracioni regjistrohen fillimisht provizorisht në një klasë, fillojnë shkollën dhe socializimin me shokët e klasës, dhe më pas, brenda një periudhe prej rreth 30 ditësh, u nënshtrohen një testimi vlerësues. Nëse nxënësi nuk arrin rezultatin e kërkuar, ai/ajo zhvendoset në një klasë më të ulët.

¹ Ankesa është plotësuar me dokumentacionin e dërguar me e-mail-in datë 05.12.2025.

² Për shkak të ankesës së paraqitur pranë Komisionerit me nr. 201, datë 30.09.2024, kundër shkollës dhe ZVAP Tiranë.

Kjo praktikë krijon disa pasoja serioze:

- *Nxënësi përjeton ndjenja turpi dhe stigmatizimi, pasi largohet nga grupi ku ka nisur integrimin.*
- *Prindërit vendosen në një situatë pasigurie për klasën ku do të vazhdojë fëmija i tyre.*
- *Kjo procedurë zbatohet vetëm për fëmijët e kthyer nga emigracioni, duke i vendosur ata në një pozitë më të pafavorshme në krahasim me nxënësit e tjerë, pavarësisht që arsimi i detyrueshëm është i garantuar për të gjithë.*

Edhe pse kjo praktikë bazohet në ligj për qëllime verifikuese, në efekt ajo sjell diskriminim indirekt, sepse:

- *I ekspozon këta fëmijë ndaj një trajtimi të ndryshëm e më të rëndë emocionalisht;*
- *Cenon të drejtën e tyre për një arsim të barabartë;*
- *Nuk merr në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, parim i sanksionuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacioni shqiptar.*

Lidhur me rastin që fëmijët iu nënshtruan provimeve, unë si prind kërkoja ndihmë tek Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, për një përfaqësues monitorimi. Megjithëse këto provime janë ekstraligjore, unë u nënshtrova në mënyrë që fëmijët të vazhdonin shkollën. Gjatë kohës që fëmijët kanë qenë në shkollë, kanë dëgjuar nga fëmijët e tjerë se “ata M. janë shumë të poshtër, merren me incizime”, etj. Gjithë kjo situatë kulmoi me dhunën verbale dhe fizike ndaj O. M., nga mësuesi F. H., koordinator i cilësisë dhe mësues shkolle, për të cilin kam bërë kallëzim për koordinatorin dhe drejtoreshën.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit:

- 1- Të shqyrtohet kjo praktikë si një formë diskriminimi indirekt ndaj fëmijëve të kthyer nga emigracioni.
- 2- Të rekomandohet ndryshimi i mënyrës së zbatimit të procedurës së njëvlershmërisë, në mënyrë që testimi të organizohet paraprakisht, përpara fillimit të vitit shkollor, duke shmangur zhvendosjen e fëmijëve nga një klasë në tjetrën pas disa javësh.
- 3- Të sigurohet që të gjitha procedurat për njëvlershmërinë të zbatohen në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Fillimisht, ankuesi kishte paraqitur një ankesë të përgjithshme, në të cilën përfshihej edhe objekti që më pas u trajtua si ankesë e veçantë me nr. 260, datë 10.11.2025. Për këtë arsye, dokumentacioni dhe aktet e administruara më herët në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 228, datë 13.10.2025, u

konsideruan të vlefshme dhe u administruan edhe për shqyrtimin e ankesës nr. 260, pasi lidhen drejtpërdrejt me objektin e saj.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe është pranuar për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara në nenin 33, pika 4, të këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1574/1 prot., datë 13.11.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi” , ZVAP Tiranë dhe Ministria e Arsimit, si më posht vijon:
 - Argumentimi juaj lidhur me pretendimin e ngritur nga prindi për mënyrën e testimit të fëmijëve të kthyer nga jashtë.
 - Informacion mbi hartimin e testeve vlerësuese: kush i përgatit, në çfarë baze ligjore dhe sipas cilave kriteret metodologjike.
 - Sqarim mbi vlerësimin e rezultateve: cilat janë standardet e kalimit dhe kush është përgjegjës për vlerësimin.
 - Të dhëna për rastin konkret të fëmijëve M.: si është zhvilluar testimi, kush ka marrë pjesë dhe nëse janë respektuar procedurat e Udhëzimit nr. 13/2023.
 - Arsytet pse testimi zhvillohet pas fillimit të vitit shkollor dhe jo paraprakisht, si dhe ndikimi që kjo ka te fëmijët.
 - Procedura e ankimit për prindërit në rast mospajtimit me rezultatin e testit.
 - Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Me shkresën nr.11823/1 prot., datë 25.11.2025³, ZVAP Tiranë, ktheu përgjigje dhe dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Në përgjigje Tuajes me nr. 1574/1 protokolli, datë 13.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 11823, datë 17.11.2025, mbi informacionin e kërkuar në lidhje me ankesën e depozituar nga ana e Z. A. M., pranë institucionit Tuaj, mbi mënyrën e testimit të fëmijëve të tij në zbatim të Udhëzimit Nr. 13, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, pas shqyrtimit të çështjes, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ju bën me dije sa më poshtë:

Z. A. M., ka paraqitur në ZVAP Tiranë kërkesën në datën 24.06.2025, për regjistrimin e fëmijëve të tij, nxënësve A.M në klasë të IX, S.M në klasë të IX dhe O.M në klasë të VIII, për Vitin shkollor 2025–2026, me dokumentacion si më poshtë: Formular aplikimi (sipas udhëzimit).

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.1574/2 prot, datë 27.11.2025.

Dokument origjinal për frekuentim shkollor të nxënësve në shtetin Belg, të papërkthyer dhe të panoterizuar (dokument që nuk fakton përfundimin e klasave përkatëse dhe nuk ka rezultate për to). Fotokopje e mjeteve të identifikimit të nxënësve A.M, S.M, O.M.

Në këto kushte, ZVAP Tiranë në datën 14.07.2025 ka bërë email zyrtar shkollës lidhur me vijueshmërinë e nxënësve M., në shkollën “Institut Technique Cardinal Mercier-Notre—Dam du Sacre-Coeur” Bruksel, në mënyrë që të shmangnim Komisionin Shkollor, nëse shkolla sillte konfirmim për përfundimin e klasave përkatëse. Përgjigje e cila nuk konfirmoi informacionin e kërkuar. Në këto kushte, në zbatim të përcaktimeve ligjore, ZVAP Tiranë kërkoi stafit drejtues të shkollës të merrte masat për ngritjen e Komisionit Shkollor.

Sa i takon pretendimit të ngritur nga Z. M., për mënyrën e testimit të fëmijëve të kthyer nga jashtë, ju sqarojmë se në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 10, KREU III, të Udhëzimit Nr. 13, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së dëftësive dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, është cituar tekstualisht: “ZVAP, në mungesë të dokumentit të vijueshmërisë së klasës 1–9, kur nxënësi nuk e ka përfunduar atë, njofton drejtorin e shkollës, që nxënësi të vlerësohet nga një komision i ngritur prej tij për klasën e pretenduar nga deklarimi me shkrim i prindit. Nxënësi regjistrohet në klasën që miraton komisioni. Drejtoria e shkollës, pas regjistrimit të nxënësit, organizon hartimin dhe zbatimin nga mësuesit të programeve individuale që synojnë plotësimin e mangësive të nxënësit”.

Lidhur me organizimin dhe zhvillimin e testeve për nxënësit A.M, klasa e IX aktualisht (testi i zhvilluar mbi arritjet lëndore të klasës VIII sipas shkresës së ZVAP Tiranë me Nr. 4855/1 Prot., datë 14.07.2025), S.M, klasa e IX aktualisht (testi i zhvilluar mbi arritjet lëndore të klasës VIII sipas shkresës së ZVAP Tiranë me Nr. 4857/1, datë 14.07.2025) dhe O.M, klasa e VIII aktualisht (testi i zhvilluar mbi arritjet lëndore të klasës VII, sipas shkresës së ZVAP Tiranë me Nr. 4856/1, datë 14.07.2025), procedura është realizuar dhe monitoruar nga stafi drejtues e mësimor i shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” Tiranë, ku janë zhvilluar testimet në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Lidhur me përfshirjen e fëmijëve M., në proces, sipas informacionit zyrtar të përcjellë nga ana e stafit drejtues të shkollës, ju sqarojmë se nxënësit M., pranë shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” Tiranë janë përfshirë në procesin e vlerësimit fillestar, bazuar në kriteret e përcaktuara në udhëzim, pas një komunikimi paraprak me prindin dhe me përfshirjen e stafit mësimor, shërbimit psiko-social të shkollës. Janë respektuar të gjitha procedurat e transparencës dhe dokumentimit.

Lidhur me pretendimet e diskriminimit

Procesi i testimit ka pasur qëllim njohjen më të mirë të nevojave të nxënësve dhe përshtatjen e mbështetjes mësimore në përputhje me to. Në asnjë rast nuk është synuar apo konstatuar përjashtim

apo trajtim i pabarabartë. Shkolla garanton respektimin e të drejtave të çdo nxënësi, në frymën e gjithëpërfshirjes dhe barazisë.

Për procedurat e ankimimit

Prindi ka paraqitur ankesa të vazhdueshme në drejtorinë e institucionit mbi të drejtën e tij për çdo problematikë që e ka shqetësuar, ku çdo ankesë e ngritur është trajtuar me seriozitet në organet kolegjiale të shkollës dhe dokumentuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim, ju konfirmojmë se janë respektuar të gjitha detyrimet ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Shkolla mbetet e angazhuar për të garantuar një proces të drejtë dhe gjithëpërfshirës për çdo nxënësi, si dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe bashkëpunues për të gjithë.

Bashkëlidhur:

- Udhëzimi Nr. 13, datë 30.06.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlefshmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit".
- Praktika e depozituar nga Z. M., në ZVAP Tiranë mbi regjistrimin e fëmijëve sipas klasave përkatëse në shkollën 9-vjeçare "Ardian Klosi" Tiranë.
- Shkresat e ZVAP Tiranë për regjistrimin e nxënësve A.M, S.M dhe O.M pranë shkollës 9-vjeçare "Ardian Klosi" Tiranë.
- Shkresa kthim përgjigje për shkollën me Nr. 8879/1, datë 22.09.2025, lidhur me procedurat e regjistrimit të këtyre nxënësve në shkollë, duke theksuar interesin më të lartë të nxënësit.
- E-mail i printuar dërguar shkollës në shtetin Belg.
- Me shkresën nr. 1574/3 prot., date 04.12.2025 të Komisionerit i është përcjellë ankuesit shkresa nr.11823/1 prot., datë 25.11.2025, për të bërë parashtrimet e tija në lidhje me këtë përgjigje. Nga ana e ankuesit nuk u dërgua asnjë përgjigje.
- Me shkresën nr.7346/1 prot., datë 18.12.2025⁴, Ministria e Arsimit, ktheu përgjigje dhe dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1574/1 prot, datë 13.11.2025, me lëndë: "Njoftim dhe kërkesë për informacioni", për ankesën me nr. 260, datë 10.11.2025, e paraqitur nga z. A. M., kundër shkollës 9-vjeçare "Ardian Klosi", Tiranë, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur, O.M, për "çdo shkak tjetër", bazuar dhe në informacionin e dërguar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë me shkresën nr. 11823/1 prot, datë 25.11.2025, parashtrojmë për sa më poshtë:

Z. A. M., ka aplikuar në portalin e-Albania, nëpërmjet formularit "Për njohje dhe njësim diplome të dëftesave të arsimit bazë/Dëftesa të Arsimit Parauniversitar", për tre fëmijët e tij të mitur, A.M,

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.1574/4 prot, datë 22.12.2025.

O.M dhe S.M, të cilët gjatë vitit shkollor 2024-2025 kanë frekuentuar institucionin arsimor "Institute Technique Cardinal Mercier - Notre-Dame du Sacre-Coeur", Bruksel, Belgjikë.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë (më poshtë referuar "ZVAP Tiranë"), pasi ka administruar aplikimet dhe ka shqyrtuar dokumentacionin e lëshuar nga institucioni arsimor belg, ka konstatuar se ky dokumentacion nuk pasqyron rezultatet për secilin nga tre nxënësit.

Për këtë arsye, ZVAP Tiranë i është drejtuar me email këtij institucioni në datën 14.07.2025, për të konfirmuar si frekuentimin e shkollës nga tre nxënësit, ashtu dhe rezultatet e tyre për vitin shkollor 2024-2025. Në kushtet kur institucioni arsimor belg nuk dërgoi informacion për rezultatet e nxënësve, komisioni i pranimi të nxënësve që kthehen nga emigracioni pranë ZVAP Tiranë, bazuar në kërkesën e prindit dhe dokumentacionin për nxënësit A.M, O.M dhe S.M, i është drejtuar shkollës 9-vjeçare "Ardian Klosi", duke e njoftuar për procedurën për regjistrimin dhe trajtimin e nxënësve që kthehen nga emigracioni, nëpërmjet shkresave zyrtare si më poshtë:

- 1. Me shkresat nr. 4855/1 prot. dhe nr. 4857/1 prot., datë 14.07.2025, me lëndë "Regjistrim dhe trajtimi i nxënësve që kthehen nga emigracioni", është njoftuar shkolla që me kërkesë të prindit dhe dokumentacionit për frekuentimin e institucionit arsimor belg nga nxënësit A.M dhe S.M, por që nuk pasqyron rezultatet e tyre, ata duhet të regjistrohen në këtë shkollë për të vijuar klasën IX, për vitin shkollor 2025-2026;*
- 2. Me shkresën nr. 4856/1 prot., datë 14.07.2025, me lëndë "Regjistrim dhe trajtimi i nxënësve që kthehen nga emigracioni", është njoftuar shkolla që me kërkesë të prindit dhe dokumentacionit për frekuentimin e institucionit arsimor belg nga nxënësi O.M, por që nuk pasqyron rezultatet e tij, ai duhet të regjistrohet në këtë shkollë për të vijuar klasën VIII, për vitin shkollor 2025-2026.*

ZVAP Tiranë, me qëllim për mos i privuar të drejtën e arsimit tre nxënësve, i ka kërkuar shkollës 9-vjeçare publike "Ardian Klosi" marrjen e masave dhe ngritjen e komisionit shkollor për të vlerësuar:

- (i) arritjet lëndore të klasës së VII për nxënësin O.M, i cili, nëse do të rezultojë kalues, do të vijojë klasën e VIII;*
- (ii) arritjet lëndore të klasës së VIII për nxënësit A.M dhe S.M, të cilët, nëse rezultojnë kalues, do të vijojnë klasën e IX.*

Për të njëjtën çështje, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me kërkesën për informacion me Nr. K5/A28-2 prot., datë 11.09.2025, e protokolluar me nr. 5258/1 prot., datë 15.09.2025.

Ministria e Arsimit me shkresën nr. 5228/1 prot., datë 19.09.2025, i ka kthyer përgjigje Avokatit të Popullit duke e informuar ndër të tjera që: pas kalimit me sukses të testimeve të zhvilluara, nxënësi O.M vijon klasën e VIII dhe nxënësit A.M dhe S.M vijojnë klasën e IX në shkollën 9-vjeçare "Ardian Klosi". Fëmijët janë pajisur me tekstet shkollore dhe janë regjistruar në sistemin SMIP.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 742, datë 03.12.2021, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)", udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësive dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar, si dhe në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijëve për t'i mos i privuar ata nga e drejta e arsimimit, për vitin shkollor 2025-2026, rezulton se nxënësit A.M, S.M dhe O.M janë regjistruar në shkollën 9-vjeçare "Ardian Klosi" në klasat respektive.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e arsimit parauniversitar, të tre nxënësit, dhe në veçanti nxënësi O.M, nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë nga institucionet që kanë kryer dhe përfunduar procedurën e regjistrimit të tyre në shkollën 9-vjeçare "Ardian Klosi", duke përjashtuar çdo situatë të mundshme diskriminimi ndaj tyre, përfshirë dhe nxënësin O.M për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Bashkëlidhur parashtimeve dërgojmë kopje të dokumentacionit të poshtëshënuar:

- 1. Shkresa e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë nr. 11823/1 prot., datë 25.11.2025, më lëndë "Kthim përgjigje", drejtuar KMD-së dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit, protokolluar me nr. 7628 prot., datë 27.11.2025, (kopje);*
- 2. Kërkesë për informacion e Avokatit të Popullit me Nr. K5/A28-2 prot., datë 11.09.2025, e protokolluar me nr. 5258/1 prot., datë 15.09.2025, (kopje);*
- 3. Kthim përgjigje e Ministrisë së Arsimit me nr. 5258/1 prot., datë 19.09.2025, drejtuar Avokatit të Popullit, (kopje);*
- 4. Kërkesë/rekomandim e z. A. M., e protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr. 5258 prot., datë 01.09.2025, (kopje).*

Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri vlerësoi kërkesën e ankuesit por dhe për sqarimin e plotë të çështjes caktoi datën 04.02.2026, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 90 prot., datë 12.01.2026.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua më datë 04.02.2026, në praninë e palës ankuese, z. A. M., si dhe të palëve ndaj të cilave është paraqitur ankesa, përkatësisht: Shkolla "Ardian Klosi", e përfaqësuar nga Drejtoresha e shkollës, znj. J. I., e shoqëruar nga psikologu i institucionit; Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë), e përfaqësuar nga znj. R. K., sipas Autorizimit nr. 806 Prot., datë 04.02.2026; si dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, znj. A. K., sipas Autorizimit nr. 388/1 Prot., datë 27.01.2026.

Megjithëse Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ishte subjekt ndaj të cilit ishte drejtuar ankesa, pjesëmarrja e saj në seancë u bë në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e arsimit parauniversitar, me qëllim dhënien e sqarimeve lidhur me kuadrin ligjor dhe procedurat përkatëse të ndjekura në rastin konkret.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime dhe pretendime si ato të paraqitura më herët në komunikimet dhe përgjigjet shkresore drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pala ankuese i qëndroi fakteve dhe provave të paraqitura, si dhe ngriti një pretendim shtesë, duke sqaruar se në vitin 2019, fëmijët që ishin kthyer nga jashtë vendit nuk i ishin nënshtruar të njëjtave kushte dhe procedura vlerësimi.

Sipas palës ankuese, procesi i vlerësimit të aftësive për përcaktimin e nivelit arsimor dhe përshtatjen përkatëse kishte sjellë pasoja negative me natyrë psikologjike për fëmijët, duke pretenduar cenim të mirëqenies së tyre emocionale dhe mendore.

Në këto kushte, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes, palëve iu la detyrë të paraqisnin dokumentacionin dhe procedurat e ndjekura në vitin 2019 për fëmijët e ankuesit ose për raste të ngjashme. Në vijim, palët, përmes komunikimit elektronik (e-mail), vunë në dispozicion të Komisionerit të gjithë informacionin ligjor dhe dokumentar të kërkuar, në funksion të administrimit të plotë të provave në këtë procedim administrativ.

Me email-i e datës 10.02.2026, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Tiranë njoftoi se në vitin 2019, gjatë regjistrimit të nxënësve të familjes M., u ndoq praktika e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 44, datë 21.08.2013, *“Për përcaktimin e procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”*, i ndryshuar dhe i zbatuar për atë periudhë. ZVAP bashkëngjiti dokumentacionin e praktikës së ndjekur nga zyra, si dhe kopjen e Udhëzimit Nr. 44, duke theksuar se akti ishte zbatuar në atë kohë, edhe pse më pas është shfuqizuar.

Me email-i datë 17.02.2026, shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi”, informoi se disponon certifikatat personale të nxënësve O. M., A. M., dhe S. M., si dhe shkresat e ardhura nga Zyra Vendore e Arsimit Tiranë me nr. prot. 5005, 5006 dhe 5008, datë 22.11.2019. Shkolla theksoi se këto dokumente ruhen në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Urdhri Nr. 31, ndërsa për sa i përket dosjes së testimeve të nxënësve, nuk ka detyrim për ruajtjen e tyre pasi afatet kohore të përcaktuara nga Urdhri janë tejkaluar. Bashkëngjitur email-it u dërgua edhe kopja e Urdhrit Nr. 31.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës,

lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga pala ankuese, në radhë të parë Komisioneri do të analizojë nëse nxënësit, në rastin konkret, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo më pak të favorshëm nga ana e institucionit arsimor dhe organeve përgjegjëse të administrimit të sistemit arsimor, përkatësisht Shkolla “Ardian Klosi” dhe ZVAP

Tiranë, në lidhje me procedurën e vlerësimit të aftësive për përcaktimin e nivelit arsimor dhe përshtatjen në sistemin arsimor parauniversitar.

Në këtë kuadër, do të vlerësohet nëse procedurat e ndjekura ndaj tyre kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe nëse ato janë zbatuar në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë krahasuar me raste të tjera të ngjashme, përfshirë praktikën e ndjekur në vitin 2019 për nxënësit e kthyer nga jashtë vendit.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Me shkresën nr. 4855, datë 24.06.2025, Zyra Vendore Arsimore Tiranë i drejtohet Shkollës 9-vjeçare publike “Ardian Klosi” Tiranë lidhur me regjistrimin e nxënësit A. A. M., i datëlindjes 24.07.2010, i ardhur nga Belgjika, për vitin shkollor 2025–2026. Në këtë shkresë, duke iu referuar ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023 dhe VKM nr. 742, datë 03.12.2021 për SMIP-in. ZVA njofton se nxënësi duhet të regjistrohet në klasën IX, por për shkak se në dokumentacionin e paraqitur nga shkolla belge mungojnë rezultatet përfundimtare të klasës VIII, kërkohet ngritja e një Komisioni shkollor brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit shkollor për vlerësimin e arritjeve lëndore; nëse rezultoni kalues, nxënësi do të vijojë në klasën IX. Po ashtu theksohet detyrimi për aplikim në portalin e-Albania në shërbimin “Rikthim në shkollë”.

Me shkresën nr. 4857, datë 24.06.2025, Zyra Vendore Arsimore Tiranë njofton të njëjtën shkollë për regjistrimin e nxënësit S. A. M., i datëlindjes 15.11.2011, gjithashtu i ardhur nga Belgjika. Edhe në këtë rast, pasi verifikohet dokumentacioni i frekuentimit pranë shkollës “Institut Technique Cardinal Mercier-Notre-Dame du Sacré-Coeur” në Bruksel dhe konstatohet mungesa e rezultateve përfundimtare të klasës VIII, kërkohet ngritja e Komisionit për vlerësim brenda afatit 30-ditor, me kusht që, nëse nxënësi rezultoni kalues, të vijojë në klasën IX për vitin shkollor 2025–2026.

Me shkresën nr. 4856, datë 24.06.2025, Zyra Vendore Arsimore Tiranë trajton regjistrimin e nxënësit O. A. M., i datëlindjes 12.11.2012, i ardhur nga Belgjika, duke kërkuar regjistrimin e tij në klasën VIII. Në këtë shkresë sqarohet se mungojnë rezultatet përfundimtare të klasës VII dhe, për rrjedhojë, drejtorja e shkollës duhet të ngrejë Komisionin për vlerësimin e arritjeve lëndore të klasës VII; nëse nxënësi rezultoni kalues, do të vijojë në klasën VIII.

Me email datë 14.07.2025, Zyra Vendore Arsimore Tiranë i drejtohet institucionit belg “Institut Technique Supérieur Cardinal Mercier” në Bruksel, duke kërkuar konfirmimin e frekuentimit dhe dërgimin e rezultateve përfundimtare për nxënësit O., S. dhe A. M., në funksion të procesit të njëvlershmërisë së dokumentacionit të tyre shkollor.

Me email datë 18.08.2025, sekretaria e institucionit “Institut Technique Supérieur Cardinal Mercier” i kthen përgjigje ZVA-së, duke sqaruar se ata nuk i kanë këta nxënës në programet e tyre

të arsimit për të rritur dhe duke sugjeruar kontaktimin e shkollës së mesme përkatëse, çka konfirmon vështirësinë në sigurimin e rezultateve përfundimtare.

Me shkresën prot.,184 prot., datë 27.08.2025 (sipas grafikut të shpallur), Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” Tiranë njofton z. A. M., për zhvillimin e provimeve vlerësuese nga data 08.09.2025 deri më 19.09.2025, sipas një kalendari të detajuar për secilën lëndë (gjuhë shqipe, anglisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari), me qëllim përcaktimin përfundimtar të klasës ku do të vijojnë nxënësit.

Me shkresën nr. 8879, datë 11.09.2025, depozitohet ankesa e z. A. M., pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, ku kundërshtohet mënyra e zbatimit të procedurës së njëvlershmërisë, duke argumentuar se regjistrimi provizor dhe testimi pas 30 ditësh krijon pasoja emocionale, psikologjike dhe sociale për fëmijët e kthyer nga emigracioni, si dhe cenon parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Me shkresën nr. K5/A28-2 prot., datë 11.09.2025, Institucioni i Avokatit të Popullit i drejtohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke njoftuar fillimin e hetimit administrativ mbi ankesën e z. A. M. dhe duke kërkuar informacion të detajuar mbi procedurat e ndjekura për regjistrimin dhe testimin e fëmijëve të tij, si dhe mbi zbatimin e Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023.

Me shkresën nr. 5258/1 prot., datë 15.09.2025, Ministria e Arsimit dhe Sportit i kthen përgjigje Avokatit të Popullit, duke sqaruar se, pas verifikimit të dokumentacionit dhe mungesës së rezultateve përfundimtare, është kërkuar ngritja e komisionit shkollor për vlerësim dhe se pas zhvillimit të testeve, nga data 22.09.2025, nxënësi O. M., vijon klasën VIII, ndërsa A. dhe S. M. vijojnë klasën IX, duke u regjistruar në sistemin SMIP dhe duke u pajisur me tekstet shkollore.

Për sa më sipër, rezulton se z. A. M., ka paraqitur pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë një kërkesë për regjistrimin e fëmijëve të tij, A., S. dhe O. M. Kjo kërkesë ishte mbështetur vetëm në një vërtetim të nxënësve, të lëshuar nga institucioni belg “Institut Technique Supérieur Cardinal Mercier” në Bruksel, pa dëftesa/certifikata zyrtare, listë notash dhe pa përkthim ose noterizim sipas parashikimeve ligjore për dokumentacionin e huaj. Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë) ka konstatuar se dokumentet e lëshuara nga institucioni arsimor belg nuk pasqyrojnë rezultatet përfundimtare për klasat përkatëse.

Në këto kushte, ZVAP Tiranë ka kryer njoftimin zyrtar ndaj shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” Tiranë, përmes shkresave nr. 4855/1, nr. 4857/1 dhe nr. 4856/1 prot., datë 24.06.2025, duke kërkuar regjistrimin e nxënësve në klasat respektive (A dhe S në klasën IX, O., në klasën VIII) dhe njëkohësisht ngritjen e Komisionit Shkollor për vlerësimin e arritjeve lëndore, për shkak të mungesës së rezultateve përfundimtare në dokumentacion. Paralelisht, është kërkuar konfirmim zyrtar nga institucioni arsimor në Belgjikë mbi frekuentimin dhe rezultatet, por pa marrë informacion plotësues mbi notat përfundimtare.

Në vijim, në zbatim të kuadrit ligjor të referuar nga institucionet, konkretisht të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të VKM nr. 742, datë 03.12.2021 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)” dhe të Udhëzimit nr. 13, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, është kërkuar që, në mungesë të dokumentacionit të plotë për vijueshmërinë dhe rezultatet, drejtorja e shkollës të ngrejë Komision për vlerësimin e nxënësve në klasën e pretenduar nga prindi.

Në zbatim të kësaj procedure, shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi” ka njoftuar prindin për zhvillimin e testimeve vlerësuese brenda afatit të përcaktuar, me qëllim verifikimin e arritjeve lëndore përkatëse (klasa VII për nxënësin O. dhe klasa VIII për nxënësit A dhe S.). Sipas informacionit të administruar, nxënësit i janë nënshtruar procesit të vlerësimit nga Komisioni i ngritur dhe kanë rezultuar kalues, duke vijuar përfundimisht në klasat respektive: O. M., në klasën VIII dhe A. e S. M., në klasën IX. Regjistrimi i tyre është pasqyruar në sistemin SMIP dhe ata janë pajisur me tekstet shkollore përkatëse.

Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë për diskriminim, trajtim të pabarabartë dhe cënim të interesit më të lartë të fëmijës, institucionet arsimore ZVAP Tiranë, shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi” dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit kanë pretenduar se procedura e ndjekur është e parashikuar shprehimisht nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e ardhur nga jashtë vendit në rastet kur mungon dokumentacioni i plotë mbi rezultatet përfundimtare.

Sipas qëndrimeve të përcjella nga institucionet, është bërë regjistrimi fillestar i fëmijëve sipas kërkesës së z. M., në klasat e pretenduara pa u penguar nga shkolla dhe vlerësimit të tyre përmes Komisionit Shkollor nuk përbëjnë masë ndëshkuese apo trajtim diferencues, por një mekanizëm verifikues të parashikuar nga Udhëzimi nr. 13, me qëllim përcaktimin e nivelit real të arritjeve dhe garantimin e vijimit të arsimit në klasën që i përgjigjet përgatitjes së nxënësit. Për rrjedhojë, ato pretendojnë se nuk ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pasi e njëjta procedurë aplikohet në mënyrë të përgjithshme për çdo nxënës në kushte të ngjashme faktike dhe ligjore.

Ndërkohë, lidhur me pretendimin e z. M., për mënyrën e veprimit të shkollës “Ardian Klosi”, referuar informacionit të administruar nga palët përmes komunikimeve elektronike, konstatohet se nxënësit O. M., A. M. dhe S. M., gjatë regjistrimit dhe procesit të vlerësimit në shkollën 9-vjeçare, në vitin 2019 i janë nënshtruar procedurave të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë periudhë. Konkretisht, në vitin 2019 është ndjekur praktika e përcaktuar nga Udhëzimi Nr. 44, datë 21.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i shfuqizuar.

Pra, në përputhje me analizën e fakteve të paraqitura dhe me legjislacionin në fuqi në atë kohë, konstatohet se nxënësit i janë nënshtruar të njëjtës procedurë vlerësimi. Kjo për shkak se, edhe në

vitin 2019, ata nuk dispononin dokumentacionin e nevojshëm sipas formës së kërkuar. Për pasojë, vlerësimi i nxënësve është kryer mbi bazën e standardeve dhe procedurave të njëjta për të gjithë individët në të njëjtat kushte, duke respektuar legjislacionin dhe kornizat rregullatore të arsimit në fuqi.

Në këto kushte, pretendimet e ankuesit konsiderohen të pabazuara, pasi dokumentacioni dhe informacioni i administruar nga institucionet arsimore vërtetojnë se nxënësit O. M., A. M. dhe S. M., janë vlerësuar në përputhje me procedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi në vitin 2019, duke respektuar standardet dhe kornizat rregullatore të arsimit parauniversitar.

E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në Kushtetutë, kushdo ka të drejtën për arsimim. Bazuar në nenin 2, të ligjit Nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, arsimi parashkollor është pjesë e arsimit parauniversitar.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 22 (Arsimi bazë) parashikon: 1. *Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen për arsimin e mesëm të lartë ose për tregun e punës.* 2. *Arsimi bazë përfshin arsimin fillor (klasa 1–5) dhe arsimin e mesëm të ulët (klasa 6–9).* 3. *Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët shqiptarë nga 6 deri në 16 vjeç, me mundësi vazhdimi deri në 17 vjeç.* 4. *Nxënësit mbi 16 vjeç që nuk e kanë përfunduar arsimin bazë mund të ndjekin arsimin me kohë të pjesshme, ndërsa ata që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa me kohë të plotë mund të ndjekin arsimin me program individual sipas udhëzimit të ministrit.* 5. *Shkollat e arsimit të orientuar mund të fillojnë në klasa të caktuara të arsimit bazë, duke siguruar formimin e mjaftueshëm të nxënësve në lëndët e përgjithshme.*

Neni 52 (Dokumentet e përfundimit të shkollimit) parashikon: 1. *Dokumenti i përfundimit të arsimit bazë është dëftesa e arsimit bazë, e cila lëshohet nga drejtori i shkollës pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë. Dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është diploma e maturës shtetërore, e cila lëshohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.* 2. *Në përfundim të çdo klase, nxënësi pajiset me dëftesë klase. Kriteret për lëshimin e dëftesës përcaktohen me udhëzim të ministrit.* 3. *Shkolla private e arsimit të mesëm të lartë e licencuar mund të lëshojë diplomë të një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të. Ministri përcakton procedurat e njësimit të këtyre diplomave.* 4. *Kriteret dhe procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit përcaktohen me udhëzim të ministrit.*

Ky nen ndër të tjera parashikon se shkollat private të arsimit të mesëm të lartë të licencuara mund të lëshojnë diploma të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to. Ministri i Arsimit përcakton procedurat për njësimin e këtyre diplomave me sistemin arsimor shqiptar, duke siguruar

që ato të kenë njohje dhe vlefshmëri të barabartë me diplomat e lëshuara nga institucionet vendase. Po ashtu, kriteret dhe procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit përcaktohen me udhëzim të ministrit, duke garantuar integritimin e nxënësve në sistemin parauniversitar shqiptar dhe vlerësimin ligjor të arsimit të tyre të kryer jashtë vendit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 03.12.2021, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)”, ka si qëllim krijimin dhe rregullimin e funksionimit të një baze të centralizuar shtetërore të të dhënave për administrimin e informacionit në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet këtij vendimi institucionalizohet SMIP si sistemi zyrtar për mbledhjen, përpunimin, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me nxënësit, personelin arsimor dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Në zbatim të këtij vendimi, veprimi që i takonte prindit është paraqitja e dokumentacionit të plotë dhe bashkëpunimi me institucionet për saktësimin e të dhënave, ndërsa hedhja, përditësimi dhe administrimi i të dhënave në SMIP përbënin detyrim të shkollës dhe të strukturave arsimore përkatëse.

Udhëzimi nr. 13, datë 30.06.2023 *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar, të ardhur nga jashtë vendit”*, i ndryshuar me Udhëzimi nr. 7, datë 30.4.2024, përcakton në mënyrë të detajuar procedurat për njohjen dhe vlershmërinë e dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit. Sipas këtij udhëzimi, institucionet kompetente për këtë proces janë ZVAP për arsimin bazë dhe dëftesat e klasave, dhe QSHA për diplomën e arsimit të mesëm të lartë. Aplikimi bëhet online përmes portalit e-Albania, ndërsa dokumentacioni dorëzohet si elektronikisht ashtu edhe fizikisht, i noterizuar, i përkthyer nga përkthyes të licencuar dhe me apostilë ose legalizim. Institucionet verifikojnë autenticitetin e dokumenteve duke kontaktuar institucionet e huaja dhe duke dokumentuar çdo veprim. Njësimi i notave bëhet sipas një table konvertimi të përcaktuar, ndërsa për sistemet e huaja jo të përfshira në tabelë, përdoren faqet zyrtare të shtetit dhe rrjeti ENIC-NARIC. Vendimmarrja kryhet nga komisionet përkatëse, të cilat lëshojnë vërtetimin e njohjes/njësimi dhe regjistrojnë rastin në regjistrin zyrtar. Në rast mungese të dokumentit të vijueshmërisë, ZVAP njofton drejtorin e shkollës, i cili formon një komision vlerësimi; nxënësi vlerësohet dhe regjistrohet në klasën e miratuar, ndërsa shkolla harton programe individuale për plotësimin e mangësive.

Sa më sipër, duke u bazuar në analizën e dokumenteve të administruara nga palët në këtë proces administrativ dhe legjislacionit të aplikuar, konkludohet se institucionet arsimore kanë vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi. Konkretisht, ZVAP Tiranë ka administruar kërkesën për regjistrimin e fëmijëve, bazuar në një dokumentacion se nxënësit kanë ardhur nga Belgjika, duke konstatuar mungesën e rezultateve përfundimtare në dokumentacionin origjinal.

Në përputhje me Udhëzimin nr. 13, datë 30.06.2023, është njoftuar drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi” për regjistrimin provizor të nxënësve dhe ngritjen e Komisionit Shkollor për vlerësimin e arritjeve lëndore të klasave të mëparshme.

Shkolla ka organizuar dhe zhvilluar testimet vlerësuese në përputhje me udhëzimet ligjore dhe ka garantuar pjesëmarrjen e nxënësve dhe përfshirjen e prindit në proces, duke respektuar procedurat e transparencës dhe dokumentimit. Pas kalimit të testeve, nxënësit janë regjistruar në klasat përkatëse (O.M në klasën VIII dhe A.M dhe S.M në klasën IX), janë pajisur me tekstet shkollore dhe janë regjistruar në sistemin SMIP sipas VKM nr. 742, datë 03.12.2021.

Kjo procedurë ka siguruar që nxënësit, pavarësisht nga dokumentacioni i sjellë nga arsimi jashtë vendit, të regjistrohen në klasat përkatëse sipas arritjeve dhe njohurive të tyre, duke garantuar vijimësinë e procesit mësimor pa ndërprerje ose humbje të të drejtave arsimore. Për pasojë, nuk ka ndodhur asnjë efekt negativ ose pengesë në zhvillimin arsimor dhe edukativ të nxënësve, duke u respektuar e drejta e tyre për arsimim cilësor, të barabartë dhe të gjithëpërfshirës.

Veprimet e ZVAP Tiranë dhe të shkollës kanë qenë në përputhje me Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, neni 52, i cili parashikon njohjen dhe njëvlershimin e dëftesave dhe diplomave, dhe me Udhëzimin nr. 13, i ndryshuar, që përcakton kriteret dhe procedurat për njohjen e dokumentave të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë.

Në këtë kontekst, qëndrimi i mbajtur nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë për administrimin e aplikimeve dhe kërkesave të nxënësve është i justifikuar. Duke theksuar se dokumentacioni i dorëzuar nga institucionet belge nuk përmbante rezultatet përfundimtare të klasave përkatëse, ZVAP Tiranë kërkoi ngritjen e Komisionit Shkollor nga drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, për të vlerësuar arritjet lëndore të nxënësve. Veprimet e ndërmarra më pas nga shkolla u zhvilluan në përputhje me Udhëzimin nr. 13, datë 30.06.2023, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 30.04.2024, Ligjin nr. 69/2012, i ndryshuar, dhe VKM nr. 742, datë 03.12.2021, duke respektuar procedurat për njohjen dhe njëvlershmërinë e dëftesave dhe regjistrimin e nxënësve që kthehen nga jashtë vendit.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit mbi supozimin për pasoja emocionale, psikologjike dhe sociale të nxënësve gjatë procesit të regjistrimit dhe vlerësimit, nga analiza e dokumenteve të administruara rezulton se nuk ekziston asnjë provë objektive, dokument mjekësor apo psikologjik që të konfirmojë ndonjë ndikim negativ nga veprimet e ndërmarra nga ZVAP Tiranë dhe shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi”. Për rrjedhojë, veprimet e këtyre institucioneve nuk kanë sjellë pasoja për fëmijët dhe nuk ka indicie që ato të kenë krijuar ndonjë cënim të mirëqenies së tyre emocionale, mendore ose sociale.

Në çdo rast, nëse subjekti pretendon se janë shkaktuar dëme të çfarëdo natyre, materiale apo jomateriale (morale), legjislacioni në fuqi parashikon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës kompetente për vlerësimin e tyre, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi përgjegjësinë civile. Vlerësimi i ekzistencës së dëmit, i paligjshmërisë, i lidhjes

shkakësore dhe i çdo elementi tjetër përbërës është atribut ekskluziv i gjykatës, mbi bazën e provave të paraqitura nga palët në një proces të rregullt ligjor.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm, si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të rastit, Komisioneri vlerëson se nxënësit A., S. dhe O. M. janë regjistruar në klasat përkatëse dhe janë përfshirë në procesin e vlerësimit sipas procedurave ligjore, duke përfshirë dokumentimin, komunikimin me prindin dhe përfshirjen e stafit mësimor, dhe se ata nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm ose të pabarabartë.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me veprime të paligjshme nga ana ZVAP Tiranë dhe shkollës “Ardian Klosi”, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të fëmijëve të mitur A., S. dhe O. M., nga Shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi” dhe ZVAP Tiranë, për shkakun e pretenduar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA